

KONTRATË SHITJE KUOTE

E lidhur në Tiranë, sot më 29 janar 2025, nga dhe ndërmjet:

A. Irgi Tola, shtetas shqiptar, lindur më 18.01.1997 në Librazhd dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J70118007E, dhe

B. Enea Kurti, shtetas shqiptar, lindur me 02.02.1999 në Librazhd dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J90202012L; *(së bashku ne vijim “Shitësi”)*

dhe

C. Klodjan Gjeçi, shtetas shqiptar, lindur me 21.05.1984 në Librazhd dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I40521077H; *(në vijim “Blerësi”)*

MEQENËSE:

- A. Z. Irgi Tola dhe Z. Enea Kurti** janë ortakët e vetëm të shoqërisë tregtare “**TBM**” **Sh.P.K.**, një shoqëri e themeluar e që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT M42430021U, me seli ne adresën: Rruga “Qemal Stafa”, Pallati 118, Shkalla 1, Apartamenti 18, Tiranë, Shqipëri, (më poshtë referuar “**Shoqëria**”), dhe zotërojnë te gjithë kapitalin themeltar të Shoqërisë, konkretisht dy (2) kuota qe përfaqësojnë 100% të kapitalit prej 100.000 (njëqind mijë) lekësh te Shoqërisë.
- B.** Shitësi dëshiron t’i shesë Blerësit dhe ky i fundit dëshiron të blejë nga Shitësi të gjitha kuotat e kapitalit të Shoqërisë, në mënyrë që Blerësi të behet ortak i vetëm zotërues i 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë;
- C.** Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkëlidhur të Asamblesë se Ortakëve të Shoqërisë, Palët dëshirojnë te lidhin këtë Kontratë.

NË BAZË TË SA MË SIPËR, PALËT RANË DAKORD SI VIJON:

Neni 1

Objekti

- 1.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Shitësi i transferon dhe kalon në pronësinë e vetme ligjore të Blerësit të gjitha kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe Blerësi blen kuotat, duke u bërë kështu ortak i vetëm i Shoqërisë, kundrejt çmimit të shitjes dhe sipas kushteve e afateve të përcaktuara në këtë kontratë.

Neni 2

Çmimi dhe Mënyra e Pagesës

- 2.1 Çmimi i shitjes së kuotave të kapitalit është i njëjtë me vlerën nominale të tyre në shumën prej LEK 100.000 (njëqind mijë lekë) dhe Palët vërtetojnë se pagesa e çmimit të mësipërm të shitjes është kryer tërësisht nga Blerësi në favor të Shitësit me lidhjen e kësaj Kontrate dhe kjo Kontratë shërben edhe si një dëftesë për vërtetimin e pagimit të shumës. Palët e vërtetojnë shlyerjen e çmimit dhe nuk kanë asnjë pretendim tjetër të asnjë lloji. **Z. Irgi Tola** dhe **Z. Enea Kurti** konfirmojnë se kanë marrë çmimin e shitjes në pjesën takuese sipas përqindjes së pjesëmarrjes në kapital.
- 2.2 Shitësi pranon të kryej të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim që t'i transferojë Blerësit kuotën në zbatim të kësaj kontrate dhe t'i mundësojë Blerësit kontrollin efektiv mbi aktivitetin e shoqërisë në të ardhmen.

Neni 3

Kushtet dhe Afati për Transferimin e Kuotave

- 3.1 Me lidhjen e kësaj Kontrate Blerësi bëhet ortak i vetëm zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë me vlerë prej 100.000 (njëqind mijë) lekë

dhe njëkohësisht Blerësit i lind e drejta e regjistrimit të pronësisë së vet mbi kuotën në librin e ortakëve dhe në regjistrin tregtar (QKB) sipas ligjit.

Neni 4

Deklarata dhe Garanci

4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:

- a) Kuota është e lirë nga çdo lloj pengu, detyrimi, e drejtë parablerjeje dhe/ose ndonjë barrë tjetër. Shitësi ka të drejtë të shesë dhe transferojë Kuotën sipas kësaj Kontrate.
- b) Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Shitësi është palë.
- c) Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

4.2 Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:

- a) Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Blerësi është palë.
- b) Blerësi njeh dhe pranon tërësisht gjendjen ligjore dhe financiare të Shoqërisë.
- c) Blerësi bie dakord të financojë shoqërinë, sipas nevojave të saj, për projektet e shoqërisë;
- d) Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

Neni 5

Dispozitat e Fundit

5.1 Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzoleve apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole

apo parashikimi nuk do të çenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.

- 5.2 Kjo Kontratë përmban marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me gojë apo me shkrim, duke përjashtuar në këtë mënyrë çdo pretendim për detyrime të mëtejshme ndërmjet Palëve.
- 5.3 Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", të ndryshuar, dhe dispozitat e "*Kodit Civil*" të Republikës së Shqipërisë.
- 5.4 Çdo konflikt në lidhje me nënshkrimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet me marrëveshje ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Kjo Kontratë u hartua në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën Shqipe dhe pasi u lexua prej palëve, u gjet e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, u nënshkrua rregullisht nga palët si vijon:

SHITËSI

Irgi Tola
Irgi Tola



Enea Kurti
Enea Kurti



BLERËSI

Klodjan Gjeçi

